

# **PRESIONI I PAFUND:**

**RAPORTIMI I MEDIAVE TË KOSOVËS PËR  
KRIMIN E ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIN**

SUPPORTED BY:



Federal Foreign Office

PUBLISHED BY:

**BYRN**

# Përmbledhje

Skena mediatike kosovare është e ngarkuar me shumë media të shkruara, elektronike dhe online të cilat janë themeluar në dy dekadat e fundit. Në mesin e këtyre mediave, ka shumë të tilla që luftojnë të gjejnë një vend në tregun e Kosovës i cili është i vogël për nga numri i lexuesve/shikuesve

dhe mjaft i kufizuar në aspekt të të hyrave nga marketingu, shumica e të cilave vijnë nga sektori publik. Një numër i madh i mediave është themeluar nga bizneset, partitë politike dhe grupe tjera të interesit, duke ndjekur agjenda të tjera dhe jo raportimin objektiv e të balancuar. Këto media i shërbejnë interesave të bizneseve dhe agjendave ditore politike.

Mediat në Kosovë i nënshtrohen presionit nga politikanët dhe bizneset për t'i mbrojtur ato nga raportimi mbi rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Mënyra se si bëhet presioni përfshin refuzimin për të bërë reklamim në atë medium që sfidon politikanët dhe bizneset, kërcënimet ndaj gazetarëve, dhuna fizike, dhe refuzimi për qasje në informata. Kompanitë publike marrin më pak vëmendje nga media për sh-

kak të fondeve që ato shpenzojnë në reklamim. Sidoqoftë, kjo varet nga profesionalizmi dhe pozita financiare e mediumit. Ata që kanë mungesë të parave dhe/apo profesionalizmit, i nënshtrohen ndikimit politik dhe të bizneseve në mënyrë që t'i mbijetojnë tregut.

Një metodë tjetër e presionit janë kërcënimet direkte dhe frikësimet e gazetarëve. Siguria e gazetarëve rrezikohet nga subjektet e pakënaqura për ata që kanë shkruar në artikujt e tyre, dhe siguria e tyre ekonomike

## Gjetjet kryesore

- Mediat në Kosovë janë subjekt i presionit nga politikanët dhe bizneset për mos t'i lejuar ato që të raportojnë mbi çështje të krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- Gazetarëve nuk u ofrohet siguri dhe kjo ndikon në raportimin e tyre në çështje të krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- Institucionet e sundimit të ligjit janë pasive në komunikim me media, dhe qasja në dokumente zyrtare nuk aplikohet në të gjitha rastet, duke bërë kështu rrjedhjen e informatave burim të rëndësishëm për informim.
- Ka një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet mediave të pavarura dhe profesionalizmit të gazetarëve. Mediave në përgjithësi u mungojnë burimet, përfshirë stafin dhe kohën për t'iu dedikuar raportimeve hulumtuese në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

nga kërcënimi i humbjes së vendeve të tyre të punës nëse punëdhënësit e tyre dorëzohen ndaj presioneve politike dhe të bizneseve në shkëmbim të përfitimeve financiare dhe favore tjera nga bizneset dhe politikanët. Kjo ndikon raportimin e tyre në rastet e krimit të organizuar, dhe nxit vetëcensurën ndërmjet shumë gazetarëve kur ata raportojnë për raste të tilla.

Qasja në informata është një nga çështjet më problematike që krijojnë pengesa për mediat që kërkojnë të bëjnë punë kualitative. Institucionet shtetërore nuk e zbatojnë ligjin për klasifikimin e dokumenteve, duke krijuar kështu konfuzion se cilat dokumente mund të qasen nga publiku (Ligji për Klasifikimin e Dokumentëve i kategorizon dokumentet publike në ato që janë konfidenciale dhe ato që mund të shihen nga publiku).

Por arsyeja kryesore pse qasja në informata është problematike lidhet me faktin që Ligji për Qasje në Dokumente Publike nuk zbatohet në mënyrë të njëjtë nga të gjitha institucionet e Kosovës, por po ashtu edhe për shkak të mosbesimit të ndërsjellë ndërmjet gjyqësorit dhe medias. Ka bashkëpunim të kufizuar ndërmjet prokurorisë dhe policisë, në njërin anë, dhe medimeve, në anën tjetër. Në këtë mënyrë, qasja formale dhe joformale në informata përcaktohet nga disa faktorë, përfshirë profesionalizmin e gazetarëve, kuptimin personal të parimeve të lirisë së informimit nga zyrtarët e gjyqësorit, dhe kultura institucionale. Gazetarët zakonisht mbështeten në informatat e rrjedhura jo-zyrtare brenda gjyqësorit dhe policisë – me policinë si burimi i parë i informatës jo-zyrtare.

Mediumet që kanë investuar në trajnimin e stafit të tyre dhe u kanë ofruar atyre sigurim të vendit të punës mund të mbështeten në profesionalizëm më të madh të stafit të tyre dhe qasje më të mire në informata. Sidoqoftë, shumica e medimeve nuk janë të nxitura që të hulumtojnë dhe prodhojnë raporte serioze mbi rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Një pengesë me rëndësi është mungesa e resurseve për të dedikuar staf të mjaftueshëm dhe kohë për raportim të këtyre rasteve.

## Metodologjia

Për qëllime të këtij raporti, BIRN ka bërë në total 24 intervista të thella me 22 profesionistë të sundimit të ligjit dhe drejtësisë, politikanë, aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë. Nga këta, tre janë intervistuar me qëllim të mbledhjes së informatave shtesë. Të gjitha 22 intervistat janë bërë me email, dhe tri (një prokuror dhe dy gazetarë) që janë intervistuar për herë të dytë janë intervistuar personalisht. Nga të intervistuarit, katër kanë qenë prokurorë që kanë trajtuar çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar, dy gjykatës, një avokat dhe një deputet. Krahas këtyre, janë intervistuar edhe shtatë aktivistë të shoqërisë civile dhe gjashtë gazetarë.

Krahas kësaj, BIRN ka bërë monitorimin e pesë medimeve, përfshirë dy TV kombëtare dhe tri gazeta për një periudhë tre mujore (prill-qershor 2017). Montorimi ka përfshirë raportet e lajmeve, analizat dhe komentet që kanë pasur të bëjnë drejtpërsëdrejti me arrestimet, hetimet në vazhdim, akuzat dhe procedimet gjyqësore, sikurse edhe problemet sistemike që prekin problemet e gjyqësorit dhe institucionet e sundimit të ligjit. TV stacionet e monitoruara kanë qenë transmetuesi publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), dhe transmetuesi privat TV 21, përderisa mediat e printuara kanë përfshirë Koha Ditore, Zëri dhe Kosova Sot. Kriteret selektuese të përdorura për këtë studim kanë qenë balancimi i mediave të pavarura (Koha Ditore, TV 21), me dy mediat që janë pronë e bizneseve (Zëri, Kosova Sot), dhe një transmetues publik, që është i prirur të ndjekë politikën e partive në pushtet. Asnjëra nga mediat e monitoruara nuk ka qenë portal.

## 1. Hyrje

Në vendet demokratike, roli i medias nuk kufizohet vetëm në informimin e publikut për punën e institucioneve shtetërore, por shkon shumë më tej, duke pasur një ndikim të thellë në nivelin e llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë, duke përfshirë çështje të tilla si sundimi i ligjit dhe lufta kundër korrupsionit. Sidoqoftë, në demokracitë më pak të zhvilluara, ku ka mungesë apo vetëm liri të pjesshme e shprehjes, mediat janë larg nga të qenit shtylla e katërt. Në fakt, më shpesh ndodh që mediat janë të kontrolluara se sa që nuk janë të kontrolluara nga qeveria, politikanët e fuqishëm dhe bizneset. Në vende si Kosova, niveli i sfidave me

të cilat ballafaqohen me mediat dhe gazetarët është i gjerë, nga një mjedis i pafavorshëm ligjor, politik dhe ekonomik, pasigurisë fizike dhe të punës, si dhe mungesës së profesionalizmit midis gazetarëve<sup>1</sup>. Kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën si raportojnë mediat në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i vitit 2016 e ka renditur Kosovën në vendin e 95-të nga 176 sa janë përfshirë në studim, duke e vendosur atë pas të gjitha vendeve në Ballkanin Perëndimor. Raporti Vendet në Tranzicion i Freedom House për vitin 2017 i ka dhënë notën 5.75 në çështjet e korrupsionit, ku nota 7 ka qenë më e dobëta. Pavarësia e gjyqësorit është renditur ulët në 5.50, me pavarësi të mediave në 5<sup>2</sup>. Pavarësisht kësaj, media e Kosovës u përshkrua si “pjesërisht e lirë” nga raporti i Lirisë së Shtypit, i cili gjithashtu publikohet çdo vit nga Freedom House.

Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e të shprehurit, përderisa legjislacioni që ka të bëjë me shpifje është në përputhje me dispozitat Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Pavarësisht dispozitave kushtetuese dhe ligjore që garantojnë lirinë e shtypit, mediat në Kosovë vazhdojnë të shoqërohen nga mungesa e pavarësisë, si në aspekt profesional ashtu edhe në atë ekonomik.

## **2. Presioni mbi media për të parandaluar raportimin raportimin mbi krimin e organizuar dhe korrupsion**

### *Presioni politik*

Shumë nga zyrtarët e gjyqësorit besojnë se ekzitojnë lidhje ndërmjet politikanëve dhe një pjese të mediave. Madje disa pretendojnë që disa gazetarë individualisht janë në shërbim të krimit të organizuar. Të tjerë, përfshirë zyrtarë të gjyqësorit dhe aktivistë të shoqërisë civile, besojnë që disa gazetarë dhe politikanë gjejnë gjuhë të përbashkët duke i bërë favore njëri tjetrit – në këmbim të ‘raportimit të duhur’, gazetarët mund të shpërblehen me pozicione në ndërmarrjet dhe institucionet publike, përderisa mediat marrin me shumë qasje në fondet publike përmes reklamave.

<sup>1</sup> Freedom House. 2017. “Liria e Medias” Në <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2017/kosovo>  
<sup>2</sup> Sistemi i vlerësimit të Vendeve në Tranzicion nga Freedom House shkon nga 0 si shkalla më pozitive deri në 7 si më negativja.

Gjyqtari Fejzullah Hasani tha se ai nuk beson që mediat që raportojnë për krimin e organizuar dhe korrupsionin janë të instrumentalizuara për qëllime politike, por prokurorja speciale Drita Hajdari argumenton që “politikanët dhe zyrtarët qeveritarë e ndikojnë raportimin mediatik” rreth krimit të organizuar dhe korrupsionit. Avokati Tomë Gashi po ashtu beson që raportimi mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin ndikohet shumë nga “politikanët me ndikim dhe zyrtarët e lartë të qeverisë”, dhe insiston që në disa raste gjyqtarët instrumentalizojnë mediat në luftërat e tyre të brendshme.

Aktivistët e shoqërisë civile në anën tjetër, besojnë që raportimi i mediave mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin vetëm në raste të rralla influencohet nga politikanët, por sidoqoftë ato prapë e përdorin atë për qëllime të tyre. Sipas Besnik Boletinit nga Preportr, një raport i bërë nga organizata “Çohu”: “Mediat që raportojnë mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar përdoren nga politikanët për betejat e tyre politike”.

Në anën tjetër, raportimi për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit shpesh minimizohet nga politikanët të cilët pretendojnë që “korrupsioni është vetëm perceptcion”, tha Visar Sutaj nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Petrit Kryeziu, prokuror në Prizren dhe ish monitories në BIRN Kosova, ka argumentuar që përderisa politikanët “kanë tendencë” për të ndikuar në raportimet e mediave, gjyqësori nuk mundet, sepse gjykimet janë të hapura për media dhe “informatat nga gjykatat janë të rregulluara me ligj”.

Gazetarët në anën tjetër insistojnë që politikanët në mënyrë të rregullt ndikojnë raportimet e mediave dhe atë në disa raste mediat dhe gazetarë individualë dorëzohen nga ky presion për çështje financiare dhe arsye të karrierës. Kreshnik Gashi, gazetar në BIRN, tha se raportimi mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin kufizohet nga disa faktorë. Për shembull, mediat që sponsorizohen nga partitë politike nuk raportojnë për përfshirjen e politikanëve në aferat korruptive. Mosdhënia e reklamave nga bizneset po ashtu ndikon mediat që të kufizohen në raportimin e përfshirjes së bizneseve dhe politikanëve të lidhur në mes vete në korrupsion dhe krim të organizuar. Përveç kësaj, vetëcensura është po ashtu çështje për shqetësim, pasi që shumë gazetarë e përdorin profesionin e tyre si një trampolinë për të shkuar në pozicione tjera.”

Presioni ndaj mediave aplikohet në shumë mënyra, duke përfshirë: mohimin e reklamave, thirrjet e drejtpërdrejta telefonike, si dhe përkrahjen financiare për media e që ndikon politikat e tyre redaktuese. Një gazetar nga TV 21 tha se “ka shumë portale që nuk u dihet saktë pronësia dhe adresa. Raportimet e tyre janë politikisht të ndikuara dhe të dobëta”.

Petrit Kryeziu, ish gazetar i BIRN dhe aktualisht prokuror, ka thënë se presioni bëhet në masë të gjerë dhe duke përdorur mënyra të ndryshme, por presioni financiar është metoda kryesore:

“Media ku unë kam punuar nuk ka qenë e ndikuar nga politika. Megjithatë, kur dëgoj kolegët e mi nga mediat e tjera, ata pranojnë telefonata nga politikanët në lidhje me artikuj të caktuar, mirëpo bllokimi më i shpeshtë (i artikujve) ndodh për shkak që redaktorët bllokojnë artikuj të caktuar për shkak të reklamave, gjë që ndodh sidomos gjatë fushatave zgjedhore. Në atë mënyrë, ata sigurojnë beneficione financiare për median e tyre. Nganjëherë kjo ndodh si një (formë tjetër) e favorit, si për shembull punësimi i anëtarëve të familjes, etj.”

Besnik Boletini nga Preportr, publikim i OJQ-së “Çohu”, është pajtuar që ka pasur presione politike dhe instrumentalizim, e që kryesisht ka ndodhur për shkak të interesave financiare:

“Nganjëherë ata (politikanët) japin informacione për kolegët nga partitë e tjera; nganjëherë ata ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë në politikat redaktoriale të mediumit, gjë që bëhet përmes financimit të disa mediave, e në raste të tjerat përmes hapjes së portaleve (të tyre) që publikojnë çkado që është në interesin e politikanëve.”

Sipas aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve, mediat e ndikuara më së shumti nga politikanët janë uebsajtet e lajmeve të krijuara nga vetë politikanët apo bizneset, mediat nacionale në pronësi të bizneseve si dhe transmetuesi publik. Të pyetur nëse ndikimi politik e përcakton atë nëse ajo media raporton mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin, apo jo, Jeton Mehmeti nga Instituti GAP ka thënë se “transmetuesi publik [RTK] rrallëherë raporton rreth krimit të organizuar dhe korrupsionit” për shkak të presionit të ushtruar në të nga qeveria.

Rrezarta Reka, një aktiviste e shoqërisë civile, është pajtuar që ka ndikim politik në mediat e financuara nga fondet publike: “Ka ndikim shumë

të madh nga politika dhe partitë politike, veçanërisht nga ata që janë në pushtet mbi mediat, duke përfshirë edhe ato media të financuara nga fondet publike.”

Kjo është mbështetur edhe nga Visar Sutaj nga KDI:

“Ka media të pavarura dhe ka media të cilat financohen nga bizneset, e të cilat ndikojnë në media në emër të politikanëve. Ka poashtu media jo-profesionale, të cilat nuk ndikohen nga askush, por të cilat thjesht kanë mungesë të profesionalizmit.”

Për kontrast, në media të pavarura, gazetarët janë të lirë të raportojnë pa marrë “sugjerime” nga politikanët apo bizneset. Megjithatë, kontrolli qeveritar i informacionit e afekton kualitetin e raportimit mediatic, veçanërisht sa i përket qasjes në dokumente, e cila nuk jepet njëjtë për të gjitha mediat nga ana e agjensioneve qeveritare dhe që nganjëherë përdoret si një mjet politik nga ana e partisë në pushtet.

## *Presioni nga bizneset*

Bizneset bëjnë presion për qëllimet e tyre. Gazetarët thonë që bizneset kryesisht tentojnë të ndikojnë te mediat që të ndalojnë raportimin e praktikave korruptive dhe aktivitetet e krimit të organizuar, përmes përdorimit të muskujve të tyre financiarë për të ushtruar presion. Për shembull, Besnik Krasniqi nga gazeta ditore Koha Ditore ka thënë që një ndërmarrje publike ka tërhequr kontratën e reklamimit me gazetën ku punon ai për ta ndalur një hulumtim gazetareske që po zhvillohej për keqpërdorime në këtë ndërmarrje publike.

Presioni në media përmes ndalimit të reklamimit siç duket është një nga format e preferuara të ushtrimit të presionit mbi raportimet për korrupsion dhe krim të orgnizuar. Artan Canhasi nga KDI ka thënë që varësia e mediave në të hyrat e reklamimit ndikon shpesh në temat që ata mbulojnë:

“Udhëhiqet nga interesat biznese të mediave. Për shembull, gati nuk ka fare raportim për ndërmarrjet publike të cilat kanë buxhet të madh për marketing. Mediat shpesh dështojnë të publikojnë artikuj që mund të rrezikojnë interesat e disa bizneseve.”



Dibran Istrefi, gazetar në Klan Kosova, po ashtu ka thënë që “krimi i organizuar lidhet me bizneset dhe ato ushtrojnë presion përmes reklamimit”.

## *Siguria e gazetarëve*

Gazetarët që punojnë për mediat e pavarura nuk frikësohen të raportojnë mbi krimin e organizuar dhe korrupsionit përkundër rreziqeve dhe presionit<sup>3</sup>.

Telefonatat nga politikanët kanë tentuar që ndalojnë publikimin apo që të frikësojnë gazetarët, kërcënimet dhe sulmet fizike janë të shpeshta. Artan Canhasi nga KDI i ka thënë BIRN-it se: “Si pasojë e mungesës së sigurisë, gazetarët kufizohen nga raportimi mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin për shkak të frikës së dhunës fizike.” Kjo çon disa gazetarë që të bëjnë vetëcensurë, ka shtuar Canhasi.

Besnik Boletini nga Preportr, publikim i OJQ “Çohu” po ashtu ka pretenduar që frika rreth sigurisë fizike parandalon gazetarët nga raportimi për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit: “Gazetarët po ashtu sulmohen fizikisht dhe sistemi ynë i prokurorisë dhe gjyqësorit nuk merret në mënyrë adekuate me këto sulme.”

“Përveç ndërhyrjeve nga jashtë, gazetarëve u bëhet presion edhe nga brenda mediat e tyre. Ata kanë kushte të këqija kontraktuale dhe të punës, kështu që ata e kanë mësuar vetëcensurën. Shumë raporte për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit janë ndaluar nga vetë shefat e mediave,” ka shtuar Boletini.

---

<sup>3</sup> Vehbi Kajtazi, gazetar i Insajderi, ishte sulmuar në tetor 2017, gjoja rreth një artikulli për përfshirjen e deputetit të Parlamentit të Kosovës Milaim Zeka në një mashtrim me viza. Sulmuesit pastaj janë identifikuar si miq të Zekës. in a visa scam.

### 3. Qasja në informacion

Mendimet në mesin e gazetarëve dhe ekspertëve rreth barazisë në qasjen në informacion janë të ndara në mes të atyre që mendojnë që mediat nuk kanë qasje të barabartë në informacion dhe atyre që mendojnë që qasja në informacion varet nga profesionalizmi i mediave. Këta të fundit mendojnë që gazetarët dhe mediat më profesionale kanë më shumë qasje në informacion se sa ato që janë më pak profesionale. Për shembull, prokurori Besim Kelmendi ka thënë se profesionalizmi i mediave “luan rol thelbësor në qasjen në informacion”.

#### *Pengesat në qasjen në informacion*

Intervistat për qëllime të këtij raporti sugjerojnë që mediat e specializuara në raportim mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar e të cilat kanë fituar kredibilitet për shkak të profesionalizmit dhe këmbënguljes të tyre, sigurojnë qasje më të mirë në informacione më sensitive. Kjo sugjeron që profesionalizmi dhe këmbëngulja shpërblehet për sa i përket ndërtimit të një marrëdhënie të mirë të punës në mes të mediave dhe prokurorëve.

“Ka pasur raste kur unë jam kontaktuar nga një gazetar i cili ka thënë që ka pasur informacione të caktuara dhe ata kanë pyetur nëse publikimi i lajmit mund të dëmtonte hetimet. Unë e kam kontaktuar prokurorin përgjegjës të rastit dhe u kam thënë që lajmi mund të publikohet ngase lajmi tashmë ishte bërë publik,” ka thënë Kelmendi.

Megjithatë, në disa raste, prokurorët janë ankuar që raportimi i mediave ka dëmtuar hetimet në zhvillim e sipër për shkak se ato kanë qenë në fazat fillestare:

Siç ka thënë Drita Hajdari, prokurorja speciale që është marrë me shumë raste të profilit të lartë:

“Shpeshherë raportimi për rastet që janë në fazat e hershme të hetimeve ka dëmtuar seriozisht proceset e hetimeve dhe ka ndikuar negativisht në rezultatin e hetimit. Kjo ka ndodhur për shkak se me këto raportime, kriminelët janë informuar që ata janë nën hetime dhe ata e kanë pasur

mundësinë që ta ndikojnë procesin hetimor duke shkatërruar provat dhe duke ndikuar në dëshmitarë dhe bashkë-kryerës të veprave, apo në ndonjë mënyrë tjetër... Unë personalisht jam marrë me raportime tendencioze kur deklaratat janë keqinterpretuar apo janë vendosur në një kontekst të përgatitur më parë.”

Kjo sugjeron që ka një mungesë të kuptimit në mes të mediave dhe prokurorëve për mënyrat e bashkëpunimit që nuk do të dëmtonin punën e askujt. Ka poashtu një besim të përhapur shumë që prokuroria është pasive në komunikimin me mediat, megjithëse prokuroria nuk ka një strategji zyrtare të komunikimit:

“Unë besoj që roli pasiv i prokurorisë dhe gjyqësorit në përgjithësi ka efekte negative në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar ... ne mund të jemi më bashkëpunues dhe më të hapur me mediat, veçanërisht me gazetarët hulumtues”, ka thënë Kelmendi.

Megjithatë, duket që rregulloret për ofrimin e qasjes në informacion janë subjekt i interpretimit nga prokurorët individualë, të cilët udhëhiqen nga përvojat personave dhe atë që ata e shohin si kufizim të komunikimit me mediat, gjë që e bën marrëdhënien në mes të dy palëve të vështirë. Prokurorja Drita Hajdari beson që megjithëse mediat mund të jenë një aleat i vlefshëm në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, ka pengesa praktike dhe ligjore që ndalojnë prokurorët që të jenë të hapur me gazetarët:

“Sipas Nenit 10 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, ne e kemi të ndaluar të japim informacione që mund të ndikojnë hetimet, prandaj është një problem sensitiv dhe mediat që duan të përmbushin misionin e tyre për të luftuar krimin nuk duhet të na sjellin në një pozitë në të cilën ne mund të zbulojmë detaje të hetimeve, prej të cilave mund të përfitojnë vetëm ata të cilën janë nën hetime”, ka thënë Hajdari.

## *Mosrespektimi i legjislacionin për lirinë e informacionit*

Në intervistat për këtë raport, gazetarët janë ankuar shumë që prokurorëve u mungon transparenca dhe që ata nuk publikojnë aktakuzat, e të cilat duhet të trajtohen si dokumente publike. Problemi kryesor në mbledhjen e informacionit janë refuzimet nga ana e institucioneve shtetërore për të dhënë dokumente dhe mungesa e respektimit të Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Publike nga institucionet shtetërore, që krijon mundësinë për zyrtarët publikë që të mohojnë qasjen në dokumente publike edhe atëherë kur ato duhet të jenë të qasshme për publikun.

Sipas Kreshnik Gashit nga BIRN Kosova: “Ka probleme në aranzhimin e intervistave dhe të takimeve dhe mungesë të qasjes në dokumente zyrtare, përderisa prokuroria nuk ofron qasje në informacionet për aktakuzat dhe gjykatat nuk publikojnë oraret e seancave gjyqësore.”

Besnik Boletini (Preportr) ka sugjeruar që kjo situatë po ashtu mund të shkojë në favor të disa gazetarëve: “Mungesa e transparencës ka krijuar privilegje për disa gazetarë të cilët kanë krijuar raporte me prokurorët, dhe ata sigurojnë qasje në dokumente të tilla [aktakuza] të cilat do të duhej të ishin publike, dhe ata këtë e paraqesin si gazetari hulumtuese.”

## *Mungesa e besimit në mes të prokurorisë dhe mediave*

Të gjeturat e BIRN-it sugjerojnë që aktualisht ka një stagnim nga mosbesimi në mes të mediave dhe prokurorëve – mediat kërkojnë të hulumtojnë dhe raportojnë mbi rastet dhe çështjet e interesit publik, përderisa prokurorët janë të obliguar ta mbrojnë konfidencialitetin e punës së tyre.

Prokurorja Drita Hajdari beson se bashkëpunimi është i mundshëm nëse raportimet e mediave ndihmojnë në luftimin kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar:

“Unë personalisht i konsideroj mediat si aleat në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Natyrisht, gazetarët profesionistë...ata duhet të kenë qëllim të sinqertë luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit,” ka thënë Hajdari.

Një mendim i ngjashëm është dhënë edhe nga kolegu i Hajdarit, Besim Kelmendi, i cili beson se “gazetarët hulumtues mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Bashkëpunimi me mediat, e veçanërisht me gazetarët hulumtues mund të sjellë përfitime edhe për prokurorinë e edhe për sistemin gjyqësor.”

Artan Canhasi nga KDI ka argumentuar në anën tjetër që publiciteti për luftën kundër korrupsionit sjell inkurajim për prokurorët: “Raportimi i rregullt i mediave mbi rastet e korrupsionit dhe të krimit të organizuar e ngrit presionin publik, dhe atëherë prokuroria bëhet aktive në ndjekjen e rasteve të profilit të lartë.”

Sidoqoftë, në anën tjetër, disa prokurorë të intervistuar për qëllime të këtij raporti kanë thënë që ka pasur raste kur prokurorët janë keqinterpretuar apo kur deklaratat e tyre janë nxjerrë jashtë kontekstit nga gazetarët:

“Ka pasur raste kur gatishmëria ime për të folur për mediat është keqpërdorur në mënyrë të tmerrshme. Fjalët e mia qëllimit janë shtrembëruar dhe keqpërorur, e çka është edhe më keq, ka qenë një rast kur unë jam kontaktuar vetëm për qëllime të formalitetit, ngase raporti tashmë ishte përgatitur për t’i shërbyer qëllimeve dhe shijeve të caktuara të dikujt,” ka thënë prokurorja, Drita Hajdari.

Gazetari i BIRN Kosova, Kreshnik Gashi, ka thënë se ndërkohë se ka probleme brenda institucioneve shtetërore mbi procedurat për klasifikimin e dokumenteve. Njerëzit që janë të autorizuar të japin qasje “shpeshherë nuk janë të sigurt se cilat dokumente duhet të jenë të qasshme e cilat jo”, kishte pretenduar Gashi.

Sipas prokurorëve të intervistuar, institucionet gjyqësore kanë zhvilluar strategji të komunikimit, kanë vendosur strukturat e komunikimit dhe kanë aprovuar rregulloret e komunikimit që do të duhej të mundësojnë një komunikim efektiv me mediat. Mirëpo, në realitet se sa janë të hapur prokurorët varet nga niveli i tyre personal i të kuptuarit të rregullave që

udhëzojnë komunikimin me media. Siç ka thënë prokurori Besim Kelmen-di:

“Po, ka raste [kur mediave nuk u lejohet qasje në informacione]. Në mesin e shumë arsyeve, kjo varet edhe nga prokurori që udhëheq hetimin dhe në Këshillin Prokurorial, ngase jo të gjithë ne që jemi prokurorë kemi njohuri të mjaftueshme rreth mediave dhe edhe kur ne ndoshta nuk do të humbasim asgjë apo nuk do të rrezikojmë procedurën hetimore, ne megjithatë hezitojmë të japim informacione ngase frikësohemi që këto informacione mund të keqpërdoren dhe mund të interpretohen sipas tekeve, dhe kjo është arsyeja pse ne hezitojmë të japim informacione për mediat.”

Gazetarët e intervistuar thonë që informacionet më të rëndësishme që nxisin raportime mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar vijnë nga burimet joformale. Pas marrjes së këtyre informacioneve, gazetarët e intervistuar kanë thënë që ata i verifikojnë këto informacione duke përdorur burimet dhe dokumentet zyrtare, nëse ekziston vullneti nga ana e institucioneve dhe personave të autorizuar të flasin për media.

Megjithatë, institucionet zakonisht nuk ndërmarrin iniciativën që të publikojnë informacione rreth rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar, ka thënë Flutura Kusari, aktiviste e shoqërisë civile dhe eksperte ligjore: “Prioriteti i tyre [gjqësorit] nuk është informimi i qytetarëve për aktivitetet e tyre në luftimin e krimin të organizuar dhe korrupsionit.”

Megjithëse Ligji për Gjykatat përcakton se të gjitha vendimet e formës së prerë/finale duhet të publikohen online, deri më tani vetëm 2,000 sosh janë publikuar, përderisa rreth 300,000 vendime janë marrë ng Gjykatat për çdo vit.

## *Strategjia konfuze e gjyqësorit për komunikim*

Niveli i transparencës ndryshon nëpër institucione të ndryshme, që do të thotë se nuk ka një politikë të unisuar në mes të institucioneve për sa i përket komunikimit me mediat; brenda qeverisë ka ministri transparente dhe ministri jo-transparente.

Institucionet shtetërore përgjithësisht nuk kanë vullnet që të ofrojnë qasje në dokumente zyrtare. Ka vonesa në ofrimin e qasjes në dokumente dhe prokuroria lëshon njoftime për arrestime apo për aktakuza në mënyrë selektive, varësisht nga ndikimi politik i personave të cilët janë arrestuar apo kundër të cilëve janë ngritur aktakuza. Nganjëherë hapja ose jo e prokurorëve përcaktohet nga mendimet personale të tyre mbi profesionalizmin e mediave. Sidoqoftë, ka persona brenda institucioneve shtetërore që vullnetarizohen të japin informacione, veçanërisht rreth keqpërdorimeve në vendet e tyre të punës.

Disa persona të intervistuar për qëllime të këtij punimi, duke përfshirë prokurorë, aktivistë nga shoqëria civile dhe gazetarë, i kanë thënë BIRN-it që brenda institucioneve të sundimit të ligjit, policia është më e hapura për media, dhe që shumica e informacioneve joformale po ashtu rrjedhin nga policia, e pastaj nga avokatët për të mbrojturit e tyre apo vetë të akuzuarit.

Përderisa prokurorët mendojnë që zbulimi i informacioneve sensitive gjatë procedurës hetimore mund ta dëmtojë vetë hetimin, kjo shihet me një nivel të lartë të dyshimit nga aktivistët e shoqërisë civile. Ata mendojnë që dështimi i gjyqësorit për t'i informuar mediat rreth aktiviteteve të tyre dhe për të dhënë qasje në dokumente rrezikon transparencën institucionale dhe dëmton reputacionin:

“Me veprimet prapa dyerve të mbyllura për të shpëtuar reputacionin e kriminelëve, autoritetet i lënë qytetarët të painformuar dhe dëmtojnë vetëveten për shkak se krijohet përshtypja që korrupsioni nuk po luftohet,” ka thënë Flutura Kusari.

Qasja në informata në gjykata dhe për gjykimet rregullohet me ligj dhe duhet të jetë e barabartë për të gjithë, mirëpo avokatët mbrojtës të intervistuar për këtë punim besojnë që mediat e kontrolluara nga qeveria kanë më shumë qasje në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, ky pretendim nuk është mbështetur nga gazetarët e intervistuar.

Mediat dhe gazetarët të cilët dërgojnë kërkesa më të rregullta dhe janë më insistues marrin më shumë vëmendje nga zyrtarët e drejtësisë. Zyrtarët e drejtësisë besojnë/presin që mediat duhet të jenë më aktive në raportimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit:

“Raportimi për krimin e organizuar dhe korrupsionin është obligim i mediave; dhe nuk i shërben vetëm qëllimit për informim të qytetarëve mirëpo është edhe një ndikimin pozitiv në parandalimin e fenomeneve sociale negative,” ka thënë prokurorja Drita Hajdari.

## 4. Standardet e ndryshme të profesionalizmit gazetaresk

---

Në Kosovë, disa media ofrojnë raportim mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar në mënyrë objektive, të bazuar në fakte dhe raportim konciz, përderisa disa të tjera shfaqin mungesë të pavarësisë dhe kapaciteteve për të raportuar në këtë temë.

Shumica e gazetarëve pajtohen që profesionalizmi në raportimin rreth krimit të organizuar dhe korrupsionit është i kufizuar te mediat që raportojnë rregullisht mbi këto çështje dhe kanë investuar në trajnimin e stafit të tyre. Megjithatë, në përgjithësi mediat kanë nevojë për trajnimin e gazetarëve të tyre për të realizuar këtë lloj të raportimit në mënyrën e duhur.

Studimi i BIRN-it ka treguar që disa gazetarë dhe profesionistë të gjyqësorit kanë këtë mendim. Mediat të cilat janë specializuar në raportimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, që kanë fituar kredibilitet për shkak të profesionalizmit dhe insistimit të tyre, marrin qasje më të mirë në informacione të ndjeshme si rezultat i besimit që kanë krijuar zyrtarët policorë e gjyqësorë në punën e tyre, kanë thënë të intervistuarit e këtij studimi.

Megjithatë, shpeshherë gazetarët kanë mungesë të njohurive dhe të kapaciteteve për të raportuar mbi rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, apo mungesës së pavarësisë. Kjo ka ndikim të konsiderueshëm në hapjen e profesionistëve gjyqësorë karshi mediave:

“Sikur në sistemin gjyqësor, ka raste të joprofesionalizmit edhe në media. Nganjëherë ka raste të raportimit të anshëm dhe jo të saktë,” ka thënë një prokuror special që merret me rastet e korrupsionit e që ka preferuar të mbetet anonim.



## 5. Mungesa e raportimeve më të shpeshta të gazetarisë hulumtuese

---

Ka mungesë të raportimit të mjaftueshëm të gazetarisë hulumtuese në Kosovë dhe shumica e aktivistëve të shoqërisë civile dhe ekspertëve të intervistuar për këtë raport besojnë që një numër i kufizuar i mediave janë aktive në hulumtimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sidoqoftë, ndikimi i këtyre raporteve ka pasur efekt të vogël në veprimet e gjyqësorit, megjithëse ka pasur raste, sikur ajo e aktakuzës kundër dy ish-ministrave të kulturës që ka qenë si rrjedhojë direkte e raportimit të mediave.

“Në parim, prokuria mban sytë hapur në përcjelljen e raporteve të mediave, ngase ka shumë raportime kualitative që përmbajnë prova të konsiderueshme. Ka pasur raste kur prokuroria ka filluar hetimet formale bazuar në raportimet e mediave. Specifikisht, është rasti i ish ministrave të kulturës, e që është hapur si rrjedhojë e raportimit të mediave,” ka thënë prokurorja Hajdari<sup>4</sup>.

Raportimi i hollësishëm dhe i thelluar është i mangët ngase hulumtimet për këto raste kërkojnë shumë kohë dhe shumë burime.

Shumica e gazetarëve të intervistuar janë ankuar që ata nuk kanë kohë të mjaftueshme për të hulumtuar raportimet për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit ngase këto storie janë më kërkuese se sa raportimi i lajmeve ditore.

---


<sup>4</sup> Të dy ish ministrat ishin liruar nga aktakuza.

# **ANEKSI**

**REZULTATET E PËRMBAJTJES  
SË ANALIZËS KUANTITATIVE  
TË MEDIAVE**

## Si ishte vendosur agenda mediale?


Hulumtimi ishte zhvilluar përmes analizimit kuantitativ dhe kualitativ të raportimit medial mbi procedurat hetimore dhe gjyqësore që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Hulumtimi i Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) ka përfshirë pesë kompani mediale në vend, dy transmetues televiziv (transmetuesin publik RTK dhe median me pronësi private TV 21), si dhe tri gazeta ditore (Koha Ditore, Kosova Sot dhe Zëri). Periudha krahasuese/mostra e marrë ka qenë tre muaj, duke filluar nga data 3 prill 2017 deri me 30 qershor 2017. Përgjatë këtyre tre muajve, janë identifikuar dhe analizuar 80 artikuj (termi “artikuj” u referohet raporteve në TV apo në gazeta të shtypura të shoqëruara edhe me fotografi, imazhe, infografika përkatëse etj.).



**Grafik 1:**  
Numri i përgjithshëm  
i raporteve për medium

# Vendosja e reportazheve

Mbi gjysmës së reportazheve (47 nga 80) u ishte dhënë hapësira që merr vëmendjen më të madhe në gazeta dhe në reportazhe televizive – në faqet e para apo në njoftimet fillestare të programeve televizive. Procedurat gjyqësore mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar po ashtu ishin vendosur edhe në sektorët e gazetave apo reportazhet në programet televizive që merren me raportimin e krimin (12 artikuj), politikë (11 artikuj) dhe shoqëri (8 artikuj).



## Gjatësia e raporteve

Gjatësia e artikujve të shtypur po ashtu dëshmon për rëndësinë e disa temave të caktuara. Në periudhën e monitoruar, janë regjistruar 47 reportazhe apo artikuj të gjatë, bashkë me 12 sosh të gjatësisë së mesme dhe 8 artikuj të shkurtë.

Sa u përket raporteve televizive, gjatësia e tyre ka ndryshuar nga 34 sekonda deri në 4 minuta në edicionet e lajmeve, përderisa artikujt e transmetuar në debatet televizive “Betimi për Drejtësi” dhe Drejtësia në Kosovë” kanë zgjatur nga 20 deri në 25 minuta.

### Grafik 3: Madhësia e artikujve/ raporteve në media të shtypura

TË MËDHA  
(MBI ½ E FAQES)

**47**

TË VOGLA  
(DERI NË ¼ E FAQES)

**8**

TË MESME  
(DERI NË ½ E FAQES)


**12**

totali  
**60**

# Ilustrimet

Sa u përket ilustrimeve të reportazheve, mediat kanë përdorur zakonisht ilustrime të shumëfish-ta (39 artikuj nga 80), që zakonisht praktikohet në raporte më të gjata. Fotografitë gjenerike të ndërtesave, turmave etj., janë përdorur në 11 raporte, ndërsa fotografi të subjekteve të raportit – të akuzuarit, të dyshuarit apo të intervistuarit – janë përdorur në gjashtë sosh. Lajmet më të shkurtra janë publikuar pa ilustrime.


**Grafik 4:**  
Ilustrimet e artikujve/  
raporteve




# Autorësia

Mediat zakonisht kanë kredituar artikujt apo raportet me emrin dhe mbiemrin e plotë të autorit. Në gati 90% të artikujve dhe reportazheve të analizuara, autorët janë kredituar me emrin dhe mbiemrin e tyre të plotë. Në tetë raste është kredituar vetëm “stafi redaktorial” ndërsa në një rast tjetër është kredituar një “agjenci e lajmeve”; vetëm në një rast nuk ka pasur fare autor të përmendur.

**Grafik 5:**  
Atribuimi i anëtarësisë




**Grafik 6:**  
Zhanri



## Zhanri

Nga numri i përgjithshëm prej 80 artikujsh apo raportesh që janë analizuar, 48 kanë qenë lajme. Në Kosova Sot kanë dominuar komentet dhe editorialet, me 28 sosh të publikuara në këtë gazetë nga ky zhanër. Vetëm tri analiza dhe një reportazh hulumtues është publikuar gjatë tre muajve në mediat e marra si mostër.



**Grafik 7:**  
Temat e reportazheve

## Temat e raporteve

Në 80 artikujt dhe reportazhet e analizuara, tema e gati gjysmës së tyre (37 raporte) ka qenë zbatim i politikave mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin. Këta artikuj janë publikuar kryesisht në gazetën Kosova Sot.

Tema e një çereku nga të gjithë artikujt e analizuar (22 nga 80 sosh) ka qenë keqpërdorimi i detyrës, përderisa shtatë raporte kanë pasur të bëjnë me përvetësimin e parasë publike. Vetëm shtatë raporte nga numri i përgjithshëm kanë qenë mbi krimin e organizuar.

Një nga rastet më të rëndësishme gjatë periudhës raportuese ka qenë gjykimi i ish-kryetarit të gjykatës së Prishtinës, Kolë Puka, që ka qenë i akuzuar për marrjen e vendimeve të paligjshme. Koha Ditore ka publikuar katër artikuj për këtë rast ndërsa Zëri ka raportuar vetëm një herë.

Një rast tjetër gjyqësor i rëndësishëm së veçantë gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë ai kundër ish ministrit të Arsimit, Ramë Buja, që ka qenë i akuzuar për keqpërdorim të detyrës. Koha Ditore ka raportuar mbi këtë rast katër herë, duke përfshirë lajmin që ak-

takuza kundër ish-ministrit ishte hedhur poshtë ndërsa TV 21 ka raportuar një herë.


Nga shtatë raportet e realizuara rreth rasteve të krim-it të organizuar, Koha Ditore ka publikuar tri raporte të ndërlidhura me ish-kryetarin e Skenderajt, Sami Lushtaku, rastin “Medicus” për trafikim të organeve dhe mungesën e verdikteve finale të gjykatave për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, ndërsa RTK ka raportuar rreth rastit të ish Ministrit të Kulturës Astrit Haraqija, një incident i lidhur me thyerjen e dyerve të zyrës së prokurimit të Qendrës Klinike Universitare, dhe konfiskimin e 312 kilogramëve marihuanë, raport që është paraqitur si “një aksion i suksesshëm i policisë”.

Gjatë periudhës raportuese, mediat e monitoruara kanë raportuar kryesisht mbi kualitetin e politikave që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin, me 38 artikuj nga numri i gjithmbarshëm. Kjo përfshin edhe komentet dhe reportazhet nga lajmet e ngjarjeve ditore.






## Nxitësit për raportim



**Grafik 9:**  
Nxitësit për raportim

Një pjesë e madhe e raportimit të monitoruar është bazuar në informatat që vinin nga procedurat gjyqësore (14 nga 80 raportet) apo në komunikata zyrtare ose konferenca për shtyp (15 raporte). Një numër i konsiderueshëm i raportimeve (26 nga 80 sosh) kanë qenë komente, shumica nga Kosova Sot, si rezultat i politikës specifike redaktoriale të gazetës.

Gjëra të tjera që kanë nxitur raportimin kanë qenë fazat e ndryshme të procedurave hetimore apo gjyqësore. Mediat që janë analizuar kryesisht kanë raportuar për probleme sistemore – politikat dhe procedurat që ndërlidhen me procesimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit (38 reportazhe), përcjellë nga raportimet mbi vetë procedurat gjyqësore.



**Grafik 10:**  
Lloji i burimeve

## Burimet

Burimet kryesore të cilat mediat i kanë përdorur gjatë periudhës së monitorimit ishin ata që kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në raste- prokuroria, gjykatat, avokatët. Përfaqësuesit e shoqërisë civile (persona nga organizatat joqeveritare, profesorë universitarë ose analistë të pavarur) janë përdorur për të dhënë komente rreth situatës së përgjithshme në gjyqësor ose në politika lidhur me sundimin e ligjit.

Përfaqësues të ekzekutivit (pesë në përgjithësi) dhe policia (gjashtë) janë përdorur si burime sekondare, si dhe përfaqësues të partive politike (në shtatë raste). Përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar janë përdorur si burime në pesë raste.

Mostra tregon numër të vogël të burimeve të paemëtuara (tre në përgjithësi).


\*Numri i përgjithshëm i burimeve është më i madh se numri i përgjithshëm i artikujve për arsye se shumica e artikujve kanë pasur më shumë se një burim

# Subjektet e raportimit

Sistemi gjyqësor në përgjithësi, së bashku me gjykatat dhe gjykatësit (qofshin ata aktualë apo të kaluarit) janë subjekti kryesor i raportimit kur është fjala te korrupsioni dhe krimi i organizuar. Në periudhën e monitoruar, ato kanë qenë subjekti i raportimeve në 48 raste.

Degët ekzekutive e legjislative janë paraqitur shumë më pak si subjekteve në artikujt që kishin të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.


**Grafik 11:**  
**Temat e raportimit**



\*Numri i përgjithshëm i temave është më i madh se numri i përgjithshëm i artikujve për shkak se dy artikuj kanë pasur nga dy tema

## Vlerësimi i përgjithshëm

Gati gjysma e artikujve dhe raportimeve kanë qenë raportime faktike dhe neutrale. Megjithatë, është me rëndësi të përmendet që 38 artikuj dhe raportime janë marrë me problemet sistemore, dhe dy artikuj të tjerë kanë trajtuar dështimet në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Një numër jashtëzakonisht i vogël i raportimeve kishin të bëjnë me sukseset në luftën kundër krimit dhe korrupsionit.



**Grafik 12:**  
Ton i Raportimit

# Për projektin:

---

Raporti është publikuar si pjesë e projektit “Ushtrimi i lirisë së mediave dhe transparencë e institucioneve të shtetit në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi”. Projekti është zbatuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN Hub, në bashkëpunim me BIRN Serbia dhe BIRN Kosova, nga prilli 2017 deri në janar 2018, në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi. Projekti është mbështetur nga fondet e Paktit të Stabilitetit të Zyrës Federale të Jashtme Gjermane.

# Meritat:

---

**Analist i shtetit:**

Arben Qirezi

**Hulumtuese:**

Adelina Ahmeti

**Monitorimi i mediave:**

Tanja Maksic (team leader), Perparim Isufi

**Koordinatorë e projektit:**

Marina Radenkovic

**Koordinatorë e shtetit për Kosovë:**

Jeta Loshaj

**Redaktor i gjuhës angleze:**

Matthew Collin

**Zhvillimi dhe dizajnimi i web-it:**

Milomir Orlovic, Branko Karapandza